



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:000608

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05484512

C.nr.135/24

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.K, të cilin e përfaqëson F.K avokat në Prishtinë rruga ..., kundër të paditurit Spitali “Sheikh Zayed” në Vushtrri, me objekt kontesti Kompensim i pagës së 13-të, me vlerë të kontestit 912.87 euro, jashtë seance me datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia për kompensimin e pagës së 13-të, e paraqitur me datë 29.12.2023, nga paditësi A.K, përmes të autorizuarit të tij, kundër të paditurit Spitali “Sheikh Zayed” në Vushtrri”, për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore.

A r s y e t i m

Paditësi A.K, përmes të autorizuarit të tij me datë 29.12.2023, ka parashtruar padi për kompensimin e pagës së 13-të në shumën prej 912.87 euro, kundër të paditurit Spitali “Sheikh Zayed” në Vushtrri”.

Me datë 16.01.2024, gjykata ia ka dërguar përfaqësuesit të paditësit Vërejtjen që në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore për padi në shumën prej 20 euro.

Përfaqësuesi i paditësit me datë 19.01.2024, e ka pranuar Vërejtjen për pagesën e taksës për padi, por edhe pas kalimit të afatit, nuk e ka bërë pagesën e taksës.

Gjykata, në këtë rast nuk gjeti se ekzistojnë konditat për lirimin e paditësit nga pagesa e taksës gjyqësore, andaj konform nenit 253 par.5 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.135/4, me datë 21.03.2024

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.